

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.18, datë 25.02.2021

PËR
MIRATIMIN E FAMILJEVE PËR FITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE
FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN SHKURT 2021

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit Nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së Nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike”, VKB-së Nr.1, datë 28.01.2021 “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor”, VKB-së Nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projekt-buxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 91 familje me një fond prej 304.180 (treqind e katërmijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë.

2. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për 9 familje me një fond prej 21.120 (njëzet e një mijë e njëqind e njëzet) lekë. Ky fond do të jetë nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike.

3. Miratimin e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike për këtë muaj gjithsej 1 familje nga fondi i Bashkisë si më poshtë :

a. Njësia Administrative Nr. 5

- Xhemile Baroti Përfituese tek 6%

4. Miratimin e futjes në skemën e ndihmës ekonomike për muajin Shkurt 2021 të 5 (pesë) familjeve, të cilat janë në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës si më poshtë:

a. Njësia Administrative Nr. 1

- Roland Çobani Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë
- Ibrahim Sinani Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3860 lekë

b. Njësia Administrative Nr. 3

- Saimir Roci Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3800 lekë.

c. Njësia Administrative Nr. 4

- Ylli Avziu Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2700 lekë

d. Njësia Administrative Rrashbull

- Ashime Rama Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë
- Ervis Kadrimi Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 4860 lekë

5. Rihyrje në skemën e ndihmës ekonomike me fond nga Bashkia 0 familje.

6. Hyrje në skemën e ndihmës ekonomike deri në 6 % e fondit të kushtëzuar 9 familje.

7. Dalje nga skema e ndihmës ekonomike deri në 6 % e fondit të kushtëzuar 0 familje.

8. Lista e 9 (nëntë) familjeve për muajin Shkurt 2021, që do të jenë përfitues të ndihmës ekonomike deri në 6 % të fondit të kushtëzuar është si më poshtë :

- Bujar Buna Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë
- Flutura Herriu Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë
- Vjollca Jora Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2700 lekë
- Vera Aliu Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë

- Xhemile Baroti Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë
- Teuta Drizati Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 3060 lekë
- Aferdita Hysenllari Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 1800 lekë
- Miranda Kaja Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2160 lekë
- Shpresa Korra Familje në nevojë me shumë përfituese në vlerën 2600 lekë

9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social.

10. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 25.02.2021




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 143 / prot.
/ /

Durrës, më 26.02.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 18 datë 25.02.2021 “Për miratimin e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% dhe fondi nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për muajin Shkurt 2021”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

